



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:234370

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05486265

AC-I-22-0636-A0001

Në ankesën e

Paditësi

G Z, fshati Sh, Istog.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH. "Dubrava", (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-1721 të datës 12 tetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 21 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS C-IV-14-1721 i datës 12 tetor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 21 mars 2014, paditësi përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEJ036-0040, të datës 19 shkurt 2014, me të cilën kërkesa e tij e datës 20 dhjetor 2013, për kompensim për paga të pa paguara në shumë prej 603.00 euro, ishte refuzuar si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Në ankesë paditësi e kundërshton vendimin e Autoritetit të Likuidimit duke pohuar se refuzimi i kërkesës është bërë me arsyetimin se ka kaluar afati prej tri viteve, për paraqitje të kërkesës, pa i marrë për bazë dëshmitë që i kishin kërkuar në AKP më 21 nëntor 2011, si dhe me kërkesën tjetër më 06 prill 2012. Po ashtu edhe me rastin e mbylljes së librezës së punës i ishte dhënë edhe një shkresë në të cilën thuhet se me rastin e likuidimit të ndërmarrjes tuaj AKP-ja atëherë AKM-ja do ti merre përsipër të gjitha obligimet e kësaj ndërmarrje. Në fund paditësi kërkon nga gjykata që të vendos në favorin e tij. Në mbështetje të ankesës, ankuesi i ka bashkangjitur kopjen e vendimit të likuidimit, kopjen e pasqyrës së të ardhurave personale për vitin 2006, kopjen e kërkesës së punëtoreve drejtuar AKP-së më 21 nëntor 2011, njoftimin lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës e datës 30 mars 2009, kopjen e Librit Amë të NSH-së.

Me 23 shtator 2021, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të theksoi në ankesë se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke pohuar se ky Vendim nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore, prandaj nuk ka bazë të shfuqizohet. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që kërkesa e paditësit ka të bëjë me rrogat që kanë mbetur të pa paguara për periudhën janar 2005- dhjetor 2006 dhe se nuk ka asnjë provë ose ndonjë dëshmi që këto paga i ka kërkuar në afatin prej 3 vitesh. Në mbrojtje në ankesë AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me 12 tetor 2021, Shkalla e I-rë e DHPGJS lëshon një urdhër për paditësin me të cilin ka kërkuar prova shtesë në mbështetje të ankesës së datës 21 mars 2014.

Më 28 tetor 2021, pala ka sjellë një parashtresë me të cilën thekson se i dërgon gjykatës disa kopje të llogaris mujore, për të cilat thekson se në mënyrë të qartë shihet lartësia e këtyre të ardhurave të cilat nuk janë paguar nga NSH-ja.

Me 12 tetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-1721, e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe e obligon të paditurën që paditësit në emër të kompensimit për paga të pa paguara për periudhën janar 2005- dhjetor 2006, t'i paguajë shumën prej 603.00 euro, ku shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit. Në arsyetim të vendimit thuhet se është vërtetuar fakti se paditësi kishte paga të pa paguara nga NSH në shumë prej 603,00 euro. Gjykata e kishte pranuar si provë relevante dhe të bazuar listën (pasqyrën e të ardhurave personale për vitin 2006), për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën janar 2006-maj 2006 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën për pagat e pa paguara. Shkalla e I-rë në arsyetim të vendimit ka theksuar se me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 603,00 euro, gjykata është bazuar në listën pasqyrën e të ardhurave personale për vitin 2006 për pagat e pa paguara, ashtu që për vitin 2006, përkatësisht për muajin janar i është njohur paga në shumë prej 119.00 euro, për muajin shkurt i është njohur paga në shumë prej 111.00 euro, për muajin mars në shumë prej 127.00 euro për muajin prill në shumë prej 119.00 euro dhe për muajin maj në shumë prej 127.00 euro. Andaj paditësit gjithsejtë i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 603,00 euro.

Në arsyetim të vendimit thuhet se paditësi në vazhdimësi e potencon periudhën kohore prej 01 janar 2005 e deri më 31 dhjetor 2006 mirëpo ankesës i ka bashkangjitur pasqyrën e të ardhurave personale vetëm për vitin 2006 të siguruar

nga NPB "Dubrava" në Istog. Mirëpo, kërkesa e tij ishte për dy vitet e lartcekura dhe shuma e përgjithshme e kërkesës përputhet në shumën e përgjithshme për 5 muajt e vitit 2006 sipas pasqyrës së të ardhurave personale nga NSH-ja si të tillë gjykata e aprovoi vetëm për muajt e lartcekur, po ashtu Shkalla e I-rë ka konstatuar se pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit është parashkruar, nuk është i saktë nga se, paditësi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL më 20 dhjetor 2013 dhe se parashkrimi ishte ndërprerë me njoftimin e datës 30 mars 2009, dhe kësaj pretendimi i të paditurës se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore. Shkalla e I-rë ka konstatuar se me letrën e datës 30 mars 2009, paditësi ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH-së dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë më rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësaj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin e pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësaj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit. Andaj duke i pasur parasysh këto arsye Shkalla e I-rë kishte ardhë në përfundim që paditësi kishte ofruar shërbime pune për NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e pa paguara në shumën e aprovuar.

Me 16 nëntor 2022, AKP-ja përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-1721, të datës 12 tetor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë i ka ngatërruar dy çështje që janë krejtësisht të ndryshme, afatin për dorëzimin e kërkesave në bazë të dëshmisë së interesit në procedurën e likuidimit që është afat për parashtrimin e kërkesave dhe afatin e dytë që ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka

kërkuar ta zbatoj në kërkesë e që i referohet pagave të pa paguara (afati i parashkrimit) që është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuara. Të dy afatet janë të ndara dhe të dallueshme dhe secili kreditor i NSH-së duhet ti përmbush këto dy afate në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa. Tutje AKP-ja pohon se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës ka pas qëllim ta njoftoj paditësin për mundësin e paraqitjes së kërkesës kreditore ndaj NSH-së, ky Njoftim nuk i mbron të drejtat e tij me mjete tjera ligjore të cilat janë në dispozicion. AKP-ja në ankesë e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi që këto paga i ka kërkuar në afatin prej 3 vitesh.

Në bazë të flet dorëzimit që ekziston në dosje, paditësi ankesën e AKP-së e ka pranuar me datë 18 dhjetor 2023, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në këtë ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesave dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 20 dhjetor 2013, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit ndaj NSH "Dubrava", (në likuidimi) Pejë, dhe kërkon kompensim për pagat e pa paguara, në shumën prej 603,00 euro. Kjo kërkesë është refuzuar si e pa vlefshme nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është e parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin e ankimuar e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, e shfuqizon vendimin e ankimuar dhe e detyron të paditurën t'ia paguaj paditësit në emër të kompensimit për pagat e paguara për periudhën janar 2005 - dhjetor 2006, t'i paguajë shumën prej 603.00 euro, shumë e cila do ti paguhet paditësit në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e I-rë përveç vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, ai ka dorëzuar në Gjykatë, kopjen e Listës së të ardhurave personale për vitin 2006, njoftimin e datës 30 mars 2009, Kopjen e Librit amëz të punësuarve, në bazë të cilit dëshmohet se paditësi renditet në numrin 152.

Bazuar në këto dëshmi si dhe në faktin që edhe AKP-ja me mbrojtjen në ankesë të dorëzuar me datë 23 shtator 2021, nuk e ka kontestuar shprehimisht lartësinë e kërkuar të kompensimit për pagat e pa paguara, me të drejtë Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka aprovuar ankesën e paditësit që atij ti paguhet shuma prej 603.00 euro dhe se shuma e aprovuar prej 603.00 euro duhet ti paguhet paditësit, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë me të drejtë ka konstatuar se pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit është parashkruar, nuk është i saktë nga se, paditësi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL më 20 dhjetor 2013 dhe se parashkrimi ishte ndërprerë me njoftimin e datës 30 mars 2009, dhe kësioj pretendimi i të paditurës se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Kolegji i Apelit ka konstatuar se duke i pasur parasysh arsyet e lartë cekuar dhe provat që paditësi/ankuesi i ka sjellë në Shkallën e I-rë pa mëdyshje vërtetohet se paditësi kishte ofruar shërbime pune për NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësioj i takon e drejta në kompensim për pagat e pa paguara në shumën e aprovuar.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se ashtu siç e thekson edhe shkalla e I-rë në

Aktgjykimin e saj, e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësit nuk i takon e drejta e pretenduar dhe në këtë mënyrë të ndikonte në vendosjen ndryshe të kësaj çështje.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 12 dhjetor 2022, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë nga Kolegji i Apelit i DHPGJS me 21 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
